




unitar

United Nations Institute for Training and Research



Projekti "Forcimi i Kapaciteteve për Zbatimin e Qasjes Ndërkombëtare
Strategjike për Menaxhimin e Kimikateve (SAICM) në Shqipëri"

2011-2013



**Draft- Termat e References për një
Komitet Ndër-sektorial të Menaxhimit
të Kimikateve (KNMK) në Shqipëri**

Shënim editorial

Ky material u përgatit në kuadër të projektit “Forcimi i Kapaciteteve për Zbatimin e Qasjes Ndërkombëtare Strategjike (SAICM) në Shqipëri. Projekti u zbatua nga Instituti i Shëndetit Publik, me Agjenci Ekzekutive Institutin e Kombeve të Bashkuara për Trajnime dhe Kërkim (UNITAR) dhe me pjesëmarrje të gjerë të aktorëve të angazhuar direkt apo indirekt në menaxhimin e kimikateve në vend.

Si bazë metodologjike për përgatitjen e këtyre termave të referencës shërbeu prezantimi i UNITAR “Forcimi i strukturës kombëtare të qeverisjes: Koordinimi ndërministror”, i mbajtur në Takimin për hapjen e projektit më 24-25 mars 2011 në Tiranë.

Në fushën e menaxhimit të kimikateve, qëllimi i koordinimit është njohja e problematikës, prioriteteve dhe aktiviteteve të lidhura me kimikatet që zhvillohen nga institucionet e ndryshme. Ndër përfitimet nga koordinimi ndërministror mund të përmendim: krijimin e sinergjisë mes institucioneve të ndryshëm, shmangien e dublikimit të përpjekjeve, identifikimin e mangësive, ndihmesën në zgjidhjen e problemeve konkrete; një koordinim i mirë do kishte si pasojë vendimmarrje më cilësore dhe më strategjike për çështjet e lidhura me kimikatet.

Drafti i parë i këtij materiali ka qenë i pranishëm në faqen e internetit www.chemicals.al që në shkurt 2012 si material për takimin e rishikimit të projektit. Ai u diskutua dhe u rishikua në takimin për rishikimin e ecurisë së projektit, mbajtur në Tiranë në datat 9-10 shkurt 2012; në këtë version janë paraqitur ndryshimet e propozuara nga pjesëmarrësit e takimit, me përjashtim të sugjerimeve mbi konsideratat financiare. Pas rishikimit, ky version publikohet në materialet e projektit në të njejtën faqe internet.

Shpresojmë që ky material të shërbejë si ndihmesë në funksionimin e një komiteti apo nën-komiteti për menaxhimin e kimikateve, krijimi i të cilit është nevojë e kohës e nxjerrë edhe më në pah në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë për integrim evropian.

Lindita Tafaj

Koordinatorë e projektit

Draft- Termat e Referencës për

Komitetin Ndërsektorial të Menaxhimit të Kimikateve (KNMK) në Shqipëri

Hyrje

1. Menaxhimi i kimikateve ka një shtrirje shumë të gjerë, duke përfshirë të gjitha kimikatet gjatë ciklit jetësor të tyre. Kjo shtrirje e gjerë e saj kushtëzon natyrën multi-sektoriale të menaxhimit të kimikateve. Me qëllim që të arrihet një përqsasjeje e integruar ndaj menaxhimit të kimikateve në nivel kombëtar, është e rëndësishme ngritja e një mekanizmi koordinues, përmes së cilit sektorë dhe aktorë të ndryshëm mund të shkëmbejnë informacionin dhe mund të koordinojnë aktivitetet e tyre.
2. Qëllimi i mekanizmit koordinues ndërsektorial të menaxhimit të kimikateve është të rrisë kooperimin dhe të mundësojë koordinimin e aktiviteteve të lidhura me menaxhimin e kimikateve ndërmjet ministrive, departamenteve si dhe partnerëve të tjerë me qëllim që të mbrojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin dhe të lehtësojnë menaxhimin e qëndrueshëm të kimikateve.
3. Termat e propozuara të Referencës për mekanizmin koordinues ndërsektorial për menaxhimin e kimikateve synojnë të sigurojnë që ky organ të jetë funksional dhe të luajë rolin e tij koordinues si dhe aktorët e ndryshëm të jenë të përfaqësuar në mënyrë sa më të përshtatshme.

Titulli i mekanizmit ndërsektorial për menaxhimin e kimikateve.

4. Mekanizmi koordinues ndërsektorial për menaxhimin e kimikateve do të quhet Komiteti Kombëtar Ndërsektorial për Menaxhimin e Kimikateve¹ (KNMK).

Mandati dhe statusi i KNMK-së.

5. Mandati i Komitetit do të jetë lehtësimi i dialogut politik; harmonizimi i mandateve si dhe, kur kërkohet nga palët e përfshira, edhe zgjidhje e konflikteve ndër-institucionale për mandatet, rolet dhe funksionet dhe lehtësimi i plotësimit të detyrimeve përkatëse statutore nga ministrinë dhe agjensinë.
6. KNMK do të veprojë si një forum këshillues për koordinim në politika dhe në vendim-marrje, për shkëmbimin e informacionit dhe kontrollin e ndërsjelltë, pa mandat për vendim-marrje detyruese.

¹ Emërtimi i mekanizmit, ashtu edhe pozicionimi i tij mund të jenë të ndryshëm. Në këtë material është bërë emërtimi i mekanizmit për efekt reference të brendshme.

Ministritë, agjensitë dhe pjesmarrës të tjerë

7. Përbërja e KNMK do të aprovohet me një Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM)³

- Ministria e Mjedisit , Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës;
- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit;
- Ministria e Qeverisjes Vendore dhe Decentralizimit;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Edukimit dhe Shkencës;
- Ministria e Punëve të Jashtme;
- Ministria e Drejtësisë;
- Instituti i Shëndetit Publik;
- Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve;
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë;
- Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave;
- Autoriteti Shtetëror për Kontrollin e Eksporteve;
- Qendra Spitalore për Toksikologjinë;
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës;
- Universiteti Bujqësor i Tiranës, Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve;
- OJQ-Menaxhimi i Kimikateve dhe Mbetjeve;
- REC-Albania Qendra Rajonale Mjedisore Shqipëri;
- OJQ – Ekomjedisi Durrës.

Rolet e KNMK

8. KNMK do të lehtësojë **bashkëpunimin** ndërmjet ministrive, departamenteve dhe agjencive të cilat kanë një mandat për menaxhimin e kimikateve. Për më tepër, do të sigurojë një forum dhe një mekanizëm për koordinimin e funksioneve të ministrive, departamenteve dhe agjencive që janë të lidhura me menaxhimin e kimikateve si dhe organizatat jo-qeveritare, siç rekomandohet në Strategjinë e Politikave Gjithëpërfshirëse dhe në Planin Global të Veprimtarive të SAICM (Qasjes Ndërkombëtare Strategjike për Menaxhimin e Kimikateve).
9. KNMK, kur do të kërkohet nga anëtarët do adresojë çështje të **mbivendosjes, dublikimeve dhe konflikteve** të mundshme ndërmjet ministrive të cilat kanë një mandat për menaxhimin e kimikateve, të cilat ngrejnë shqetësime mbi politikat e përdorura si dhe zgjidhja e të cilave mund të kërkojë domosdoshmërisht ndryshim të ligjeve të lidhura me menaxhimin e kimikateve dhe mbetjeve të rrezikshme.

³ Institucionet, agjencitë dhe shoqatat e përmendura janë vendosur vetëm si shembuj dhe si orientim. Me krijimin e Komitetit, duhet të vendosen institucionet, agjencitë dhe shoqatat konkrete.

10. Një funksion tjetër kryesor i mekanizmit ndërsektorial është promovimi dhe **krijimi i një forumi për dialog politik** midis ministrive të ndryshme, agjencive dhe aktorëve (palëve) jo-shtetërore për identifikimin e boshllëqeve në politikat dhe kuadrin ligjor, burimet njerëzore, teknike dhe financiare.
11. Mekanizmi i koordinimit ndërsektorial do të shërbejë si **një rrjet për shkëmbimin e informacionit ndërmjet anëtarëve të mekanizmit**. Aktualisht, mandatet ministrore janë të një karakteri sektorial dhe ka një shkëmbim horizontal të kufizuar të informacionit. Mekanizmi i koordinimit ndërsektorial do të identifikojë kategoritë e të dhënave, shkëmbimi i pakufizuar i të cilave ndërmjet anëtarëve të mekanizmit duhet të inkurajohet, dhe kategori të tjera të dhënash të cilat mund të kufizohen për të ruajtur të drejtën e fshehtësisë ose që mundësohen vetëm me një kosto për përdoruesin.
12. Mekanizmi i koordinimit ndërsektorial do të shërbejë si një forum për konsultimin mes agjensive qeveritare dhe jo-qeveritare për veprime të propozuara nga një agjensi e mandatuar në lidhje me aplikimin për regjistrimin dhe lejeve për importin, eksportin, prodhimin, përdorimin dhe ruajtjen e kimikateve dhe pesticideve.
13. Nëpërmjet mekanizmit të koordinimit ndërsektorial mund të inkurajohet dhe lehtësohet shtimi i vlerave nëpërmjet pasurimit të procesit të vendim-marrjes me kontributet nga anëtarët e mekanizmit, të cilët do të përfshijnë ekspertët mbi çështjet e menaxhimit të kimikateve. Lidhja në rrjet e inkurajuar nga ky mekanizëm do të lehtësojë gjithashtu identifikimin e ekspertëve (kombëtarë dhe ndërkombëtarë) të cilët do të kontribuojnë dhe do të shtojnë vlerat e procesit vendimmarrës. Praktika mund të inkurajohet në mënyrë të tillë që përpara se të ndërmerren vendime të politikave të rëndësishme dhe përpara se të jepen lejet në lidhje me disa aplikime kyçe, duhet të konsultohet dhe të merret inputi i mekanizmit për koordinimin ndërsektorial .
14. Mekanizmi koordinues ndërsektorial mund të jetë një ndërmjetës midis ministrive të ndryshme dhe agjensive dhe të lehtësojë zgjidhjen e konflikteve që mund të dalin nga jo-konformiteti i agjensive qeveritare. Komiteti do të sigurojë mekanizmat për të lehtësuar zgjidhjen, pa u dashur të përdoren masa shtrënguese, për shembull me anë të krahasimit të praktikave më të mira, të mekanizmave të rishikimit dhe të dialogut të brendshëm për të ndihmuar zgjidhjen.
15. Mekanizmi koordinues ndër-sektorial do të promovojë sinergji në zbatimin e marrvëshjeve ndërkombëtare mbi kimikatet.
16. KNMK do të rishikojë periodikisht dhe, nëse është e nevojshme, do të përditësojë Profilin Kombëtar të Menaxhimit të Kimikateve.

Çështje organizative dhe operacionale

17. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujrave do të ofrojë funksionet e sekretariatit për KNMK.
18. KNMK do të kryesohet nga përfaqësuesi i caktuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe nga një bord i përbërë nga përfaqësues të ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

19. Përfaqësuesi i caktuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave është përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të sekretariatit si dhe përfaqësimet zyrtare në forume të ndryshme kombëtare.
20. Ministrinë/agjensinë anëtare propozojnë formalisht përfaqësuesit e tyre në KNMK me kërkesë të Ministrit të Mjedisit ose vullnetarisht. Propozimet dërgohen në sekretariatit e KNMK.
21. Me propozim dhe monitorim të kryetarit të vet, sekretariati planifikon, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet e lidhura me KNMK-në duke përfshirë shpërndarjen e programit, pjesëmarrjen në takime, përgatitjen e raporteve të takimeve dhe raportimi i rekomandimeve. Sekretariati është përgjegjës për shpërndarjen e programit të gjithë anëtarëve në kohën e duhur përpara çdo takimi.
22. Komiteti mund të zhvillojë mbledhje në se më shumë se 50% e anëtarëve janë të pranishëm.
23. Rekomandimet e takimit do të vendosen me konsensus atje ku një gjë e tillë është e mundur. Në atë rast kur konsensusi nuk është i mundur, rekomandimet do të bëhen me një shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast balotazhi, personi që ushtron funksionin e kryetarit do të ketë të drejtën e një vote të dytë.
24. KNMK mund të vendosë (me konsensus apo me një shumicë votash) të kërkojë palë të cilët nuk janë anëtarë të komitetit të marrin pjesë në mbledhje, me qëllim që ata t'i japin KNMK informacion të rëndësishëm, material apo njohuri.
25. Për çështje teknike specifike mund të krijohen grupe pune *ad hoc* me vendim të Komitetit. Sekretariati i KNMK-së do të luajë funksionet e sekretariatit për të gjitha grupet e punës.
26. Sekretariati raporton brenda 4 javësh rezultatet dhe rekomandimet të gjithë anëtarëve për çdo takim të KNMK-së, në varësi të nivelit të takimit.
- 27.
28. Mbledhjet e komitetit do të mbahen në mënyrë periodike, në çdo rast, jo më pak se një herë në 6 muaj. Sekretariati mundet të organizojë një takim të KNMK-së kur të paktën tre nga anëtarët e KNMK bien dakord që një takim i tillë është i nevojshëm.
29. Asnjë anëtar i KNMK-së nuk mundet të marrë pjesë në një diskutim kur një gjë e tillë mundet të shkaktojë konflikt interesi.

Konsiderata financiare

30. Sekretariati kujdeset për vendin e takimeve si dhe aspekte të tjera logjistike për takimet e KNMK. Pjesëmarrja në takime bëhet me shpenzimet e anëtarëve të tij.

Miratimi

31. KNMK funksionon bazuar në Vendim të Këshillit të Ministrave i cili do të rrjedhë nga Ligji i Kimikateve (për t'u rishikuar në 2013).